



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:278422

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643267

KPPP.nr.2141/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “GLOBAL-ING” Sh.P.K., me adresë në Pakashticë e Poshtme, me NUI: 811870931, kundër debitorit “TREPÇA” Sh.A., me adresë në Mitrovicë Parku Industrial p.n, me NUI: 811278747, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.160/2023 të datës 29.11.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Arben Gashi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “TREPÇA” Sh.A., ashtu që Urdhri P.nr.160/2023 i datës 29.11.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Arben Gashi MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.160/2023 të datës 29.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.18/23 të datës 18.04.2023, dhe faturës nr.29/2023 të datës 05.07.2023, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit borxhit

4,707.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore sipas tarifës së përbaruesve, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumentet në bazë të të cilave është marr urdhri përbarues nuk janë të përshtatshme për përbarim dhe nuk janë dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar. Më tej ka theksuar se në fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit ashtu siç parashihet me nenin 27 par.1 të LPP-së, si dhe nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar, ashtu siç parashihet me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përbarim P.nr.160/23 të datës 29.11.2023.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se në nenin 2 të kontratës, thuhet se kontrata duhet të përmbushet brenda 30 dite, dhe kreditori i ka realizuar të dy kontratat brenda afatit, ku për këtë janë dëshmitë e fletëpranimeve, e po ashtu edhe referenca në të cilën ceket se kontrata është kryer brenda afatit ligjor. Më tej ka theksuar se faturat janë origjinale dhe të protokolluara në Trepça, ndërsa fletëpranimet janë kopje me indigo të origjinalit. I ka propozuar gjykatës që t'i mundësoj kreditorit për realizimin e të drejtës duke iu bërë pagesa e faturave në mënyrë që kreditori t'i paguajë borxhet ndaj palëve të treta.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbardim dokumentet e besueshme: faturën nr.18/23 të datës 18.04.2023, dhe faturën nr.29/2023 të datës 05.07.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2141/23, me datë 30.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.